



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2020:153818  
Datë: 25.01.2024  
Numri i dokumentit: 05242726

**C.nr. 29/22**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje me gjyqtarin individual Genc Hasani, në çështjen juridike të paditëses V. Z. nga M. të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat Uvejs Gashi nga Mitrovica, kundër të paditurës Komuna e Leposaviqit, baza juridike, kontest nga marrëdhënia e punës, më datë 22.01.2024 jashtë seancës gjyqësore nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

**APROVOHET MARRËVESHJA JASHTËGJYQËSORE** me numër C.nr. **29/22** e datës 10.01.2024 (Nd:584/23) e arritur në procedurën e ndërmjetësimit, në mes paditëses V. Z. nga M. kundër të paditurës Komuna e Leposaviqit dhe e njëjta marrëveshje ka fuqinë e titullit ekzekutiv-përmbarues.

**Arsyetim**

Paditësi me datën 06.11.2020 pranë kësaj gjykate kanë paraqitur padinë për kompensimin e shpenzimeve të transportit, shujtës ushqimore dhe pagës jubilarë për periudhën kohore 18.04.2017-18.04.2020.

Me datën 16.01.2024, gjykata është njoftuar se palët kanë arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit pranë ndërmjetësuesit B. I, i cili këtë marrëveshje me shkrim i'a ka dorëzuar gjykatës.

Gjykata, pas analizimit të shkresave të cilat gjinden në lëndë konsiderojë se janë plotësuar kushtet për aprovimin e kësaj marrëveshje të arritur në procedurën e ndërmjetësimit dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Sipas nenit 15 paragrafi 4 i Ligjit për Ndërmjetësimin *“Nëse Ndërmjetësimi fillon me vetëinicimin e palëve, marrëveshja e arritur me shkrim e nënshkruar nga palët dhe*

*ndërmjetësuesi, e cila përmban klauzolën (vërtetimin) mbi plotfuqishmërinë dhe ekzekutueshmërinë e marrëveshjes, ka fuqinë e dokumentit përmbarues në përputhje me ligjin përkatës për procedurën përmbarimore.”*

Prandaj, gjykata, bazuar në arsyet e cekura më lartë, e duke u bazuar në dispozitën e nenit 15 paragrafi 4 të Ligjit për ndërmjetësimin, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

**Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**

**C.nr. 29/2022, me datë 25.01.2024**

Gjyqtari  
Genc Hasani

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet e drejta në ankesë.

Numri i lëndës: 2020:153818  
Datë: 25.01.2024  
Numri i dokumentit: 05242726